



2 nëntor 2017

KOMUNIKATË PËR MEDIA

MBLEDHJA E BORDIT TË DREJTORËVE TË AKP-SË

Prishtinë – Bordi i Drejtorëve i Agjencisë Kosovare të Privatizimit mbajti mbledhjen e tij të rregullt me datën 30 tetor dhe 1 nëntor me ç’rast shqyrtoi dhe miratoi listën e valës së shitjes së aseteve me Likuidim 38A, valë kjo që përfshin 11 prej aseteve më atraktive në Kosovë, të cilat paraqesin një mundësi të shkëlqyer për investitorët potencialw që kanë interesim për zgjerim të biznesit apo iniciativa të reja biznesore në rajonin e Prishtinës. Bordi miratoi edhe listën e aseteve të propozuara për valën e shitjes 38 e cila përmban në vete gjithsej 123 asete në tërë Kosovës por që numri më i madh i tyre është në rajon të Prishtinës. Pranimi i ofertave për këto dy valë të shitjeve pritet të bëhet me 6 dhjetor 2017.

Gjatë kësaj mbledhje Bordi i Drejtorëve miratoi Planin e Punës të Njesisë së Auditimit të Brendshëm si dhe Strategjinë e rishikuar për vitet 2018-2020. Bordi në të njëjtën kohë shqyrtoi dhe miratoi raportin e Komisionit për shqyrtim të ankesave në lista për 20% të punëtorëve të NSH KB Dumnica Podujevë, si dhe raportin e Komisionit të Banesave në pronësi të ndërmarrjeve shoqërore. Bordi miratoi edhe pesë Raporte për përcaktim të statusit për ndërmarrjet shoqërore si dhe disa qiradhënie të aseteve të NSH-ve.

Veç kësaj, në këtë mbledhje Bordi ka miratuar edhe raportet e shpërndarjes së përkohshme për kreditorët e dy ndërmarrjeve shoqërore NSH Termosistemi dhe NSH SHAM Iliri në Prizren nw vlerë përfarsisht 40,000 €, ndërkaq ka shqyrtuar dhe miratuar rritjen e buxhetit për tre ndërmarrje shoqërore në likuidim NSH Automoto Prishtina, Hotel Grandi dhe NSH Unimont.

FUND